

VENDIM
Nr. 159, datë 29.10.2019

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SHA,
ME NR. 274, SERIA T15, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 35, DATË 4.3.2015, PËR VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/5 prot, datë 23.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për licencimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 529 prot, datë 2.9.2019, ka paraqitur kërkesën për rinovim licence në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 143, datë 24.9.2019, ka filluar procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., nr. 274, seria T15, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 35, datë 4.3.2015, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 35/43, datë 24.9.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a.

- Me shkresën nr. 588 prot, datë 29.9.2019, u njoftua shoqëria, lidhur me vendimmarrjen e bordit, si dhe me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar në aplikim.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 588/1 prot, datë 11.10.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., është mbajtëse e licencës me nr. 274, seria T15 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të bordit të ERE-s, nr. 35, datë 4.3.2015, me afat 5-vjeçar, afati i së cilës përfundon në datë 4.3.2020.

- Rezulton se shoqëria ka aplikuar 4 muaj para përfundimit të afatit për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, e cila është në përputhje me afatin ligjor për paraqitjen e kërkesës për rinovim licence.

- Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, geramat: “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, geramat: “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Devoll Hydropwer” sh.a., me nr. 274, seria T15 të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 35, datë 4.3.2015, në veprimtarinë e Tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar që nga data 5.3.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE BORDI
Erjola Sadushi